

Drogë, armë zjarri dhe municione luftarake në banesë, pranga 26-vjeçarit vlonjat

10:30 26/08/2020

Share

f

t

in

✉

t



77,477 Fansa

PËLQEJE

Policia e Vlorës ka bërë të mundur arrestimin e një 26-vjeçari pas kontrollit në flagrancë që u bë në banesën e tij.

26-vjeçarit me initiale A. Dh., iu gjet në banesë një sasi e konsiderueshme municioni luftarak prej 2395 fishekësh, si dhe një sasi lënde narkotike cannabis sativa, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet i kaluan Prokurorisë Vlorë, për hetime të mëtejshme, për veprat penale “Armëmbajtja pa leje” dhe “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”.

Njoftimi i policisë:

Në vijim të kontrollit të territorit për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e paligjshmërive, bazuar dhe në informacionet e siguruara në rrugë operative, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Vlorë, në bashkëpunim me specialistët e Seksionit të Hetimit të Narkotikëve pranë DVP Vlorë organizuan dhe finalizuan me sukses operacionin policor të koduar “Befasia”.

Si rezultat i këtij operacioni u arrestua në flagrancë, në banesën e tij shtetasi A. Dh., 26 vjeç, banues në Vlorë.

Shërbimet e Policisë, gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e këtij shtetasi gjetën një armë zjarri kallashnikov, një sasi municioni luftarak prej 2395 fishekësh, si dhe një sasi lënde narkotike cannabis sativa, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet i kaluan Prokurorisë Vlorë, për hetime të mëtejshme, për veprat penale “Armëmbajtja pa leje” dhe “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”. /Ra.My.Fjala.al/

Like Share 986 people like this. Sign Up to see what your friends like.

ETIKETA 26-vjeçari arrestohet droge dhe municione Fjala.al

Share
f
t
in
✉
t

Lajme të tjera



Tirana e madhe pa fat, Zvezda kualifikohet me shumë vuatje

Kryesore | 10:11 26/08/2020



Greqi/ Rritje e të prekurve me covid-19, humb jetën një person

Aktualitet | 10:08 26/08/2020



Dobësimi i dollarit apo forcimi i euros – çfarë po ndodh në tregjet monetare?

Aktualitet | 10:07 26/08/2020



Eduard Halimi për humbjen e Thimio Kondit: Humbje e madhe për shtetin e së drejtës

Aktualitet | 09:48 26/08/2020

Web TV



Studimi i Revistës gjermane/ Në 45 vjet u vranë në kufi...

09:41 24/08/2020



Nejmar-Leva, një sfidë brenda sfidës së finales Champions

14:41 23/08/2020



Rruga që ndryshoi rrjedhën e jetës, nga biznesmenë në ‘viktima’ të...

10:37 22/08/2020

Fjala është e lirë. Liria është fuqi!

E-mail : info@fjala.al

Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të Fjala.al. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e FJALA.al, është shkelje e të drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi.

FJALA MEDIA GROUP
NUIS/NIPT : L92423005H

Na ndiqni në



Facebook



Instagram



Youtube